



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-103

Prishtinë, më 8 prill 2013, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 PRILL 2013

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti dhe Glauk Konjufca, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Sasha Milosavleviq.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Eshref Vishi dhe Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Emrush Haxhiu, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga zyra e Presidentit: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 prill 2013,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 prill 2013

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 2 prill 2013.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e mbetura nga mbledhja plenare, e filluar më 4 prill 2013, vendosi që ajo t'i vazhdojë punimet të mërkurën, më 10 prill 2013, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Votimi i rezolutës lidhur me tjetërsimin e pronës publike dhe shoqërore gjatë periudhës 22 mars 1989 deri më 10 qershor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
2. Debat parlamentar lidhur me ndryshimin e politikave fiskale në funksion të nxitjes, rritjes së prodhimit të vendore dhe zhvillimit ekonomik në tërësi, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Kelmendi, i mbështetur nga deputetët nënshkrues,
3. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vendimin e Presidentes së Republikës së Kosovës për kthimin e Ligjit nr. 04-L-163 për mallrat e liruar nga tatimi doganor dhe mallrat me tarifë zero të tatimit doganor,
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Buxhet dhe Financa për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2012,
6. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2012,
7. Miratimi i marrëveshjes së deputetëve nga radha e komuniteteve tjera joshumicë për zgjedhjen e nënkryetarit të Kuvendit nga këto komunitete.

Ndërsa për mbledhjen plenare të radhës, Kryesia vendosi që ajo të mbahet të enjten, më 11 prill 2013, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për turizmin,
5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për inspektoratin dhe mbikëqyrjen e tregut,
6. Debat parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptarë të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rekomandimeve të komisioneve parlamentare.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave

1. Rekomandimi i Komisionit për Arsim dhe i Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për njohjen e stazhit të punës të mësimdhënësve për periudhën e vitit shkollor 1990/91 deri më 1998/99

Për Rekomandimin e Komisionit për Arsim dhe të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për njohjen e stazhit të punës të mësimdhënësve për periudhën e vitit shkollor 1990 deri më 1999 diskutuan: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, nënkryetar i Kuvendit; Adem Grabovci, kryetar i G/P të PDK-së dhe Ismet Beqiri, kryetar i G/P të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryesia vendosi që rekomandimet e komisioneve të lartshënuara të radhiten në rend dite për mbledhjen plenare më 11 prill 2013, së bashku me debatin parlamentar lidhur me statusin e pazgjidhur të punëtorëve të arsimit shqiptar të Republikës së Kosovës nga viti 1990 deri në vitin shkollor 1999, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të LDK-së.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Gjeorgji

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i nënkryetarëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës; z. Xhavit Haliti dhe z. Petar Miletqi për të marrë pjesë në Seminarin e 83-të të NATO-s, që do të mbahet në Tbilisi-Gjeorgji, prej datës 28 prill deri më 2 maj 2013.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në pikën një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

3. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Strasburg-Francë

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit në këtë përbërje: Hydajet Hyseni-Kaloshi dhe Vjosa Osmani, si dhe zyrtari i protokollit Snoudon Daci për të marrë pjesë në takimin e radhës të Këshillit të Evropës, që do të mbahet në Strasburg - Francë, prej datës 24 deri më 26 prill 2013.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale